



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA E TIRANËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Data 10.05.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfshirë publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE SUVENIRE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **44423000-1**

VLERAE FONDIT LIMIT: **2.911.120** (dy milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranëka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përfjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë

si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permblehdhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2021, 2022**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatasht 1,164,448 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e tetë) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gjëma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2021, 2022**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Kjo kërkësë konsiderohet e përbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkësave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Shënim: Kjo kërkesë përbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nenit 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose **582,224 (pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e katër)** lekë pa tvsh.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

Ose

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkësave të legjispcionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave/ artikujve objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor.

Argumenti: *Ky sherbim do te ofrohet gjate gjithe vitit kalendarik 2023 sa here qe AK do te kete nevoje. Per kete arsyeshem suporti per kryerjen e ketij sherbimi prane ambjenteve te Bashkise Tirane sipas kerkesave te ketij autoriteti në mënyrë që edhe kontrata t ë realizohet me sukses dhe të mos hasen pengesa apo vonesa në realizimin dhe lëvrimin në kohë të mallit.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë diten dhe oren e hapjes se ofertave nga një moster ne ambjentet e AK (Drejtoria e prokurimeve), 1(një) copë për artikujt/mallrat objekt prokurimi. Mostrat e kërkuaara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuaara në DST, si më poshtë:

- Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël duhet te jetë e argjenduar; me ketëdimensione: Lartësi 22 cm x 3.5 gjeresi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuara ose me dedikim.
- Medalione mirënjoyje, falenderimi, Nënë Terezë. Medalionet duhet të jenë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të jenë me material bakër; me diametër \varnothing 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Duhet të jetë e paketuar ne kuti druri ose të veshur me kadife të kuqe dhe shirit kuq e zi, të personalizuara. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnjë e errët, kadife. Çelësi i Qytetit të Tiranës duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi duhet të jetë i vendosur në kuti druri ngjyrë kafe. Kutia ku do të vendoset çelësi duhet të ketë këto dimensione: 21.5 cm x 21.5 cm. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnjë e errët, kadife. Çelësi duhet të jetë i vendosur në qendër të kutisë. Çelësi duhet të ketë logon e Bashkisë Tiranë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenit 40, pika 6, gërmë a) ku cilësohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi përvlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën përmes. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën përdorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin përpjekur në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël duhet të jetë e argjenduar; me keto dimensione: Lartësi 22 cm x 3.5 gjeresi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuara ose me dedikim.
2. Medalione mirënjoyje, falenderimi, Nënë Terezë. Medalionet duhet të jenë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të jenë me material bakër; me diametër \varnothing 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Duhet të jetë e paketuar ne kuti druri ose të veshur me kadife të kuqe dhe shirit kuq e zi, të personalizuara. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) përtu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnjë e errët, kadife. Çelësi i Qytetit të Tiranës duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi duhet të jetë i vendosur në kuti druri ngjyrë kafe. Kutia ku do të vendoset çelësi duhet të ketë këto dimensione: 21.5 cm x 21.5 cm. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) përtu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnjë e errët, kadife. Çelësi duhet të jetë i vendosur në qendër të kutisë. Çelësi duhet të ketë logon e Bashkisë Tiranë.
3. Çelësi i Qytetit të Tiranës duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi duhet të jetë i vendosur në kuti druri ngjyrë kafe. Kutia ku do të vendoset çelësi duhet të ketë këto dimensione: 21.5 cm x 21.5 cm. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) përtu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnjë e errët, kadife. Çelësi duhet të jetë i vendosur në qendër të kutisë. Çelësi duhet të ketë logon e Bashkisë Tiranë.

Specifikit teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikit teknike, përmallrat objekt prokuromi, përshtakuajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mëllrat si të pranueshme përfunksionet e kërkuar si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- *Përsa i përket artikullit **Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël**: Sasia: 130 copë, me dimensione Lartësi 22 cm x 3.5 gjeresi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuara ose me dedikim, *sqarojmë se specifikimet e kërkua janë të domosdoshme pasi kjo kullë sahati karakterizon kulturën dhe historinë e qytetit të Tiranës dhe jep imazh shumë të qartë të kullës së sahatit të Tiranës. Është një dhuratë e cila u jepet qytetarëve shqiptar ose të huaj, në rast festash zyrtare dhe ngaresh historike. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësinë e ruajtjes sa më mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”**
- *Përsa i përket artikullit **Medalione mirënjohje, falenderimi, Nënë Terezë**: Sasia 17 copë, Medalionet duhet të janë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të janë me material bakër; me diametër ø 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Ky medallion të jetë patjetër me këto specifikime sepse jepet si dhuratë nga kryetari I Bashkisë në shenjë falenderimi për personalitetë të njoitura të artit dhe kulturës dhe për shërbime të shquara të kryera për qytetin e Tiranës, për qytetar të vendit tonë dhe të huaj që kanë dhënë kontribut në fusha të ndryshme. Janë të personalizuar dhe AK I kërkon rast pas rasti. Mbrapa medalionit operatori fitues merr përsipër shkrimin sipas kérkesave të AK. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësië e ruajtjes sa më mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”*
- *Përsa i përket artikullit Çelësi i Qytetit të Tiranës, sasia 35 copë duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi i Qytetit të Tiranës është specific dhe simbolik si shenjë mikpritjeje për mysafirët e qytetit. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësië e ruajtjes sa më mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **22.05.2023 ora 12:00**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje suvenire”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- Dokumentat e tenderit.